



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 502/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr. 502/2019 e datës 22.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me te cilën ka kërkuar që të shpallet i vlefshëm një fletëvotim në Vendvotimin 2070A/01D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 22.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.502/2019 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më 21.11.2019 rreth orës 19:00 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave në kutinë e votimit 2070A/01D është gjetur një fletëvotim i kontestuar ku shihet se shenja tik është shënuar në katrorin e koalicionit Nisma-AKR-PD, mirëpo më poshtë tek rubrika me numër rendor 130 tek subjekti politik “Kosova Nevi Romani Partia” KNRP, është shënuar një shenjë, si dhe në rubrikën me numër rendor 125 të subjektit politik “FJALA” është shënuar një pikë.

Sipas parashtruesit të ankesës shenjat të cilat janë shënuar në fletëvotimin 2070A/01D, bëjnë të pavlefshëm votën e qytetarit dhe kërkon që fletëvotimi nga kjo kuti e votimit të shpallet i pavlefshëm.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit: 2070A/01D është e shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim nga ana e QNR-së, në të cilin shihet se shenja “tik” është shënuar në katrorin e koalicionit Nisma-AKR-PD, mirëpo më poshtë tek rubrika me numër rendor 130 tek subjekti politik “Kosova Nevi Romani Partia” KNRP, është shënuar një shenjë, si dhe në rubrikën me numër rendor 125 të subjektit politik “FJALA” është shënuar një pikë. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e numërimit e ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pa vlefshëm sepse të metat apo gabimet të cilat i referohet QNR-ja janë kritere që e bëjnë të pa vlefshëm një fletëvotim.

Paneli, me rastin e vendosjes së ankesës dhe përgjigjes në ankesë ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se fletëvotimi i gjetur në kutinë e votimit 2070A/01D duhet të shpallet i pavlefshëm për shkak të mos përmbushjes së kritereve për të qenë e vlefshme e njëjta.

Në fletëvotimin që është ekzaminuar shihet se shenja “tik” është shënuar në katrorin e koalicionit Nisma-AKR-PD, mirëpo më poshtë tek rubrika me numër rendor 130 tek subjekti politik “Kosova Nevi Romani Partia” KNRP, është shënuar një shenjë, si dhe në rubrikën me numër rendor 125 të subjektit politik “FJALA” është shënuar një pikë. Kështu që Paneli ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se i përmbush kriteret e vlefshmërisë, dhe duhet t’i bashkëngjitet rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 502/2019 më datën 24.11.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.